



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2022:028650

Datë: 22.07.2022

Numri i dokumentit: 03258791

P. nr. 100/2022

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm, përmes gjykatëses së vetme gjykuese, Luljete Shabani, në lëndën penale kundër të akuzuarit A.Sh, për shkak të veprës penale, Rrezikimi i trafikut publik, nga neni 370 par. 8 lidhur me par. 6 dhe 1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore, Departamenti i Përgjithshëm në Gjilan, PP. II. nr. 1731/2021, të datës 10.02.2022, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor dhe publik, më datën 13.07.2022, mori dhe në prezencë të palëve, shpalli, ndërsa, më datë 21.07.2022, përpiloi këtë:

AKT GJYKIM

I akuzuari A.Sh, me nr.personal ..., nga babai F.dhe nëna S., e gjinisë S., i lindur më datë ... me vendbanim në Gjilan, ,, i martuar, baba i dy fëmijëve, ka të kryer fakultetin, i punësuar te "... i gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës,

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse, më datë 14.10.2021, rreth orës 08.50. min. në rr. në rr. "...", në Gjilan, nga pakujdesia ka rrezikuar trafikun publik, duke vënë në rrezik jetën e nejrëzve dhe pasurinë, , në atë mënyrë që derisa ka qenë me automjetin e markës "... me targa ..., duke lëvizur mbrapa, me qëllim të daljes nga parkingu, duke mos u kushtuar kujdes të veçantë këmbësorëve, e në kundërshtim me nenin 53 par.1 dhe nenin 151 të Ligjit për rregullat e trafikut rrugor, nr.05/L-088, në mënyrë të pakujdesshme , me pjesën e pasme të automjetit e ka goditur këmbësoren R. Q., e cila ka qenë duke ecur nëpër trotuar, në drejtim të rr. "...", me ç'rast, nga goditja e dëmtuara është rrëzuar në skaj të rrugës dhe ka pësuar lëndime të rënda trupore, e cila është detyruar të kërkojë ndihmë mjeksore në Spitalin Regjional të Gjilanit-Qendra Emergjente, e më pas është ndalur për trajtim të mëtejshëm në Repartin e Ortopedisë,

-me çka, ka kryer veprën penale, **Rrezikimi i trafikut publik, nga neni 370 paragrafi 8 lidhur me par.6 dhe 1 të KPRK-së**, andaj, Gjykata, bazuar në dispozitat e neneve 7,17,21, 42, 44, 72 par.1.6, 108 të KPRK-ës, dhe nenit 365, 453 dhe 463 të KPPRK-së,

E GJYKON

Të akuzuarin A.Sh me Dënim me Burg, në kohëzgjatje prej **6 (gjashtë) muajve**, ashtu që, në mbështetje të **nenit 44 të KPRK-së**, me pëlqimin e të akuzuarit, dënimi i shqiptuar me burg, **do t'i zëvendësohet në Dënim Gjore**, në shumë prej **2000 (dy mijë) €**, të cilin dënim i akuzuari është i obliguar ta paguajë në afatin prej **15 ditësh** nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi.

Në bazë të nenit 39 par.4 nënpar. 3.1 të Ligjit për kompensimin e viktimave të krimit, të akuzuarit i shqiptohet taksa në shumën prej **30 (tridhjetë) €**.

Obligohet i akuzuari që t'i paguajë shpenzimet e procedurës penale dhe paushallin gjyqësor në lartësi prej **20 (njëzetë) €**, te gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi.

E dëmtuara, për realizimin e kompensimit material, udhëzohen në Kontest civilo-juridik.

Në bazë të nenit 59 të KPRK-së, i akuzuari lirohet nga dënimi plotësues, për shkak të rrethanave lehtësuese.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore, Departamenti i Përgjithshëm në Gjilan, ka paraqitur Aktakuzën PP. nr. 2081/2021, të datës 20.01.2022, për të akuzuarin Shkëlzen Miftari, për shkak të veprës penale, **Rrezikimi trafikut publik, nga neni 370 par. 8 lidhur me par. 6 e 1 KPRK-së** dhe ka kërkuar që i akuzuari të shpallet fajtor dhe të dënohet me dënim meritator sipas ligjit.

Meqenëse i akuzuari A.Sh, në seancën fillestare të dt. 13.07.2022, ku të poranishëm ishin prokurorja Kujtesa Fazliu, i akuzuari A.Sh dhe e dëmtuara R.Q., i akuzuari A.Sh e ka pranuar fajsinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, pa presion, i njoftuar nga ana e gjykatës lidhur me pasojat dhe benefitet e pranimit të fajsisë duke lutur gjykatën që dënimin e paraparë me burg, t'i zëvendësojë me dënim gjore .Pranimi fajsisë nga ana e të akuzuarit A.Sh përputhet edhe me provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës, siç janë, Raporti mbi aksidentin, me nr. ..., të dt. 04.10.2021, Raporti i oficerit, deklarata e vet të akuzuarit, deklarata e të dëmtuarës R. . e dhënë në Spitalin Rajonal në Gjilan, fotot nga vendi i ngjarjes, Raporti mjeksor, me nr. . në emër të Ramize Qerimit dhe fletë-lëshimi me nr. të historisë . lëshuar nga Reparti i Ortopedisë i Spitalit të Përgjithshëm në Gjilan, më dt. 30..01.2022 andaj, nuk pati nevojë të administrohen prova të tjera materiale.

.E dëmtuara R. Q. deklaroi se nuk i bashkëngjitet ndjekjes penale ndaj të akuzuarit, por, kërkon kompensim materila në kontest civil.

Me rastin e matjes dhe shqiptimit të dënimit, gjykatësja mori parasysh si rrethanat lehtësuese, poashtu edhe ato rënduese, me ç'rast rrethanë lehtësuese mori pranimin e fajsisë për veprën penale e cila i vihet në barrë, shprehjen e pendimit nga ana e tij, kërkim faljen ndaj të

dëmtuarës, gatishmërinë e shprehur për t'i mbuluar të gjitha shpenzimet e trajtimit mjeksor, si dhe faktin e dëmtuara deklartoi se nuk i bashkëngjitet ndjekjes penale ndaj të akuzuarit, zotimin e tij se më nuk do ta përsërisë këtë veprë penale, e as ndonjë tjetër, fakti se për herë të parë ka rënë ndesh me ligjin, moshën e tij relativisht të re, lëndimi i shkaktuar ndaj të dëmtuarës, ndërsa, si rrethanë rënduese, shkallën e përgjegjësisë, dhe peshën e veprës penale.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është i bazuar në nenin 453 të KPPRK -së.

Nga të cekurat më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM
P.nr. 100/2022, më datë 21.07.2022**

**Gjykatësja e vetme gjykuese,
Luljete Shabani**

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë Departamenti i Përgjithshëm, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të së njejtës, ankesa dorëzohet në dy ekzemplarë, përmes kësaj Gjykate.